

V E N D I M

Nr.35, datë 21.1.1999

PËR RIORGANIZIMIN E DREJTORIVE TË POLICISË NË PREFEKTURA

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 9, të ligjit nr.7504, datë 30.7.1991 “Për policinë e rendit”, me propozimin e Ministrisë së Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Riorganizohen drejtoritë e policisë në prefektura, dhe të gjitha strukturat e shërbimeve përbërëse, me mision drejtimin e lartë, kontrollin dhe koordinimin e veprimtarisë së komisariateve në territorin e prefekturave. Drejtoria është përgjegjëse për realizimin e parimeve dhe të misionit të policisë, nëpërmjet zbatimit korrekt të ligjeve, akteve nënligjore në fuqi dhe të parimeve të përgjithshme të drejtimit të policisë. Drejtoritë janë në varësi të drejtpërdrejtë të Ministrisë së Rendit Publik.

2. Në përputhje me misionin dhe detyrat e përgjithshme, ministri i Rendit Publik miraton kompetencat dhe detyrat funksionale të drejtorive të policisë në prefektura dhe të strukturave përbërëse.

3. Struktura, përbërja organike e këtyre drejtorive, si dhe të komisariateve e të shërbimeve të veçanta, në varësi, miratohen nga ministri i Rendit Publik, brenda limitit organik, ekzistues, të miratuar.

4. Emërimi, shkarkimi dhe lëvizja nga detyra e drejtorëve të drejtorisë së policisë në prefektura bëhet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit të Rendit Publik.

5. Policia e rretheve Shkodër, Durrës, Elbasan, Fier, Berat, Korçë dhe Vlorë, deri më tani e organizuar në dy komisariate, të riorganizohet në një komisarjat të vetëm.

6. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.665, datë 2.9.1996 “Për krijimin e drejtorisë së policisë, Tiranë”; nr.320, datë 15.8.1997 “Për krijimin e drejtorive të policisë në rrethet Shkodër, Durrës, Elbasan, Fier, Berat, Korçë dhe Vlorë dhe Korçë”; nr.473. datë 3.11.1998 “Për krijimin e drejtorive të policisë në prefektura” shfuqizohen.

7. Efektet, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i vitit 1999, miratuar për Ministrinë e Rendit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko